



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION



Nr. 1314/2017
Për: z. Imer Beka, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë
Nga: Osman Havolli, kryetar i OAK
Datë: 20/10/2017
Lënda: Kërkesë për shfuqizimin e urdhëresës A.49/17 në raport me avokatët

I nderuar Kryeprokuror z. Beka,

Ju shkruajmë lidhur me Urdhëresën A.49/17 të datës 23/02/2017 me të cilën keni urdheruar stafin e sigurimit që në hyrje të objektit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë të urdherohen të gjithë personat (në përjashtim të Prokurorëve, Policëve dhe puntorëve të Objektit C) që të dorëzojnë; armët, telefonat, fotoaparartet, kamerat dhe çdo mjet tjetër. Urdhëresë e bazuar në qëndrimin e kolegjiut të prokurorëve.

Qe nga data e nxjerrjes së kësaj urdhërese, OAK ka pranuar ankesa të vazhdueshme nga ana e avokatëve të cilët nga stafi i sigurimit të PTHP janë trajtuar në mënyrë të njëjtë si qytetarët e rendomt apo të pandehurit, konform kësaj urdhërese dhe nga të njëjtit vazhdimisht është kërkuar dorëzimi i telefonave në hyrje të PTHP.

Këshilli Drejtues i OAK, ka shqyrtuar shqetsimet e avokatëve në raport me këtë urdhëresë dhe ka konstatuar se barazimi i statusit të avokatit në ushtrimin e detyrës zyrtare brenda objektit të PTHP me statusin e qytetarëve dhe të pandehurve është i papranueshëm, e gjithashtu i papranueshëm është edhe ndalimi i telefonave të avokatëve nga stafi i sigurimit të PTHP.

Në cilësinë e Kryetarit të OAK-së, kam kontaktuar disa herë me Ju i nderuar z. Kryeprokuror për të shprehur shqetsimet e avokatëve në lidhje me këtë urdhëresë. Gjithashtu është mbajtur edhe një takim në mesë të përfaqësuesve të PTHP dhe përfaqësuesve të OAK me datë 19/09/2017 ku janë adresuar shqetsimet e avokatëve dhe kërkesa e Këshillit Drejtues, kemi marrë premtimin e juaj se do të ri shqyrtohet kërkesa për shfuqizimin e kësaj urdhërese në raport me avokatët.

Kështu që kërkesa e Këshillit Drejtues të OAK-së dhe Avokatëve, është që të bëni shfuqizimin e urdhëresës për kontrollin dhe ndalimin e telefonave në raport me avokatët.

Me respekt,


Osman Havolli, Kryetar

Adresa: Prishtinë, Rr. Bedri Pejani nr 31, Tel 038 244586 e-mail: info@oak-ks.org